

SHËNIME PËR LIBRAT

MOZAIKU I NGJYRAVE DHE DRAMACITETI I BRENDSHËM I NJË POETI

Shefqet Dibrani, "STREHËT E GJAKUT", poezi, botoi Sh.B. "Faik Konica", Prishtinë 2000.

Duke u munduar të analizojmë substancën aktive të poezisë në integrimin e saj me njeriun, kemi lënë pas dore një aspekt tjetër po aq të rëndësishëm të këtij procesi. Është fjala për prezencën e rolit të popullit të poezia. Ngaqë gjakderdhja i la shqiptarët e Kosovës me një animikë të përkohëshme në fytyrë, mund të poetizojmë se lumenjtë e gjakut kanë kaluar edhe nëpërmes penës së poetit Shefqet Dibrani. Nuk është aspak e domosdoshme të thërrasim në ndihmë Freud-in, për t'na interpretuar teorinë psikodinamike të ëndrrave të popullit të Kosovës gjatë luftës. Gjithçka në lidhje me këtë tragjedi është e kompozuar, pa nota surrealiste, në librin e ri poetik "Strehët e Gjakut".

Shefqet Dibrani, si autor i këtij libri, luftën në Kosovë nuk na paraqitet si një britmë të trishtuar në ëndërr. Aty Kosova na paraqitet si një realitet i hllur, si një nëndetëse ku marinarët e saj çajnë gjirin e një tragjedie me përmasa infinitive, si një ferr i gjallë, mbështjellur në një kurorë prej gjembash, rreth kokës së fundshkullit që sapo kaloi. Prandaj mbetet i domosdoshëm përqëndrimi i plotë në studimin e poezisë të këtij libri. Them kështu, sepse poezia është një art që ta ngushton mundësinë e shijimit të plotë, nëse vetëm e lexon atë. Ajo na jepet po aq e kthjellët në detale, sa ç'jemi ne kur i studiojmë hollësisht që afrohen aty. Te "Strehët e Gjakut", linjat domethënëse janë përcuese të një dramaciteti të ri, si në formë ashtu edhe përmbajtje, në botën e njeriut tonë bashkëkohorë. Ndryshe nga librat e mëparshëm të Dibranit, në "Strehët e Gjakut", lexuesi i pavëmendshëm mund të mbetet si një udhëtar i humbur në një qytet të nëndheshëm metaforash. Le të provojmë të futemi në thellësinë e vargjeve të mëposhtme, të cilat i shkëputa nga poezia "Fërfëllima e gjethit nga putrat e barbarëve": "Po vijmë të harbuar.../ Nuk ngjajnë me barin pas shiut./ Po vijmë për të shkretuar tokën./ Për t'ja prishur ëndrrat fëmijës... ». Këtu subjekti i poezisë ka në themel historinë e përpjekjes serbe për eliminimin e shqiptarëve në Kosovë. Vargjet kanë në vetvete një kuptim të gjerë dramarik. Në domethënien e dyfishtë të secilit varg, poeti i përgjithëson dukuritë e ndryshme të realitetit me një përgjegjësi të lartë artistike. Nga vetë titulli i poezisë "Fërfëllima e gjethit nga putrat e barbarëve" ndjejmë ftesën e parë drejt një kontrasti të veçantë emocional. Është gjendja kritike që kaloi vendi i tij, ajo që e detyron Dibrani të paraqitet si një poet krejt tjetër në krahasim me vëllimet e tij të mëparshme. Duke e përjetuar nga afër virusin vdekës të shqiptarëve, që evidencialisht ai i do aq shumë, poeti nuk ka se si t'i mbështjellë ndryshe në imagjinatë serbët, veçse metaforikisht t'i kafshëzoi ata në gjallesa me putra. Ky ton trishtues poetik që ndjejmë në këto vargje është një pasurim i ri në bagazhin krijues të Dibranit. Vargje të tilla do të ishin pothuajse të pamundu-

ra, sikur sfondi i gjakderdhjes të mos ishte shtrirë aq pastër para syve të tij. Kur flasim për letërsinë e antikitetit, të rilindjes, të romantizmit, të realizmit socialist e deri të letërsia e sotme, integrali i këtyre funksioneve emëruese nuk ka të bëjë prerë me një segment kohor. Fakti që i dallojmë kaq lehtë ndryshimet esenciale midis këtyre letërsive, ka të bëjë më tepër me potencialin historik të ngjarjeve se sa me stilin e të shkruarit nga shkrimtarët dhe poetët. Vini re se si në vargjet e mëposhtme poeti Dibrani e le më një anë muzikalitetin e mirëfilltë poetik, me qellim që lexuesi të ketë të bëjë direkt me simbiozën e ushtarit me luftën: "O zot,/ Ndero këtë ditë/ Dhe vdekjen e ushtarit shtyje/ Se nëna qëndron pranë tij...". Vargjet e mësipërme, të cilat i shkëputa nga poezia me titull "Një çast i lig", mund të shërbejnë edhe si model i tingullit poetik që përshkon tërë librin. Këtu, siç shihet, poeti e ka ruajtur spontanitetin. Kjo është një gjë për tu admiruar në poezinë e Dibranit, sepse sa më i dukshëm të jetë spontaniteti në poezi, aq më e padukshme është evidenca për një poezi të kërkuar. Poeti në fjalë ka merita edhe në një aspekt tjetër: ai bën që t'na duket i lehtë kompozimi i një historie të tërë, në një poezi të vetme, pa rrëshqitur fare në prozaizëm.

Nga ana tjetër, fakti që burimi i artit të tij qëndron në lidhje me jetën, e bën të pa mënjënueshme dukurinë e forcës ushtruese të popullit ndaj tij si poet. Ja një fragment nga poezia "Kohët e Mugëta", që është ilustrim i frymëzimit të poetit të Populli dhe të poezia popullore: "Uri patët në tokën plot gurë/ E këmbët pa larë pranë lumit me ujë/ ...deshët tokën e lirë me diell...". Ky shtesim i leksikut të poezisë popullore, brumosur me fjalët e sferës së tij artistike, nuk është një mangësi nga ana e poetit. Përkundrazi, kur poeti arrinë të vënë në funksion të poezisë së tij thesarin e çmuar të artit popullorë, kemi të bëjmë më tepër me një sofistikim të nevojshëm se sa me një huazim sa për të mbijetuar momentin poetik.

Natyrisht, populli që ata i përkasin, mbetet një fat i rrallë për poetët. Është shumë e vërtetë që poetët janë si satelitë humanist në shërbim të njëzëmit. Ata jo vetëm që transmetojnë te brezat e sotëm, e më vonë te ata të ardhshëm, dramacitetin, dhembjet, sakrificën, krenarinë, fitoret dhe humbjet personale e publike të një populli, në një periudhë të veçantë kohore, por edhe jetojnë me ajërin e këtyre momenteve në krijimet artistike të tyre. Pavarësisht nga kjo, populli është burimi kryesor i frymëzimit të poetit. Askush, të paktën deri tani, nuk e imagjinonte Shefqet Dibrani si poet të luftës. Por pasi të kemi lexuar "Strehët e Gjakut" është e natyrshme të ndjejmë ndryshime në hapsirën e mendimit. Dibrani paraqitet aty si një dëshmitar nga afër, si një historian nga larg dhe si pjesëmarrës i luftës në shpirt. Sikur lufta në Kosovë të ishte

vetëm një lojë virtuale, me siguri edhe Dibrani do të mbetej virtual në poezinë e tij për luftën. A nuk do të ishte hipokrizi, sikur të përpiqeshim ta mohonim faktin që populli e natyralizon poetin të veprojë me një orjentim specifik në krijimtarinë e tij?

Në kushte të tilla Dibrani, si poet, e ka pranuar veten në rolin e një gjuhe sensitive që provon shijet e jetës, në rastin tonë të jetës së shqiptarëve, tamam ashtu siç provon një nënë lëngjet e ngrohta, për shije dhe nxehtësi, para se me to të ushqejë foshnjën e saj. Ja se si në poezinë "Kënga e jetës", ai vë talentin poetik, bagazhin kulturorë dhe labirintet më të fshehta të shpirtit të tij në shërbim të artit poetik: "Kënga e natës vetë më barti./ Me dehu e më bëri me flatra.../ E qielli lëkundet andej - këtej/ Ngase këmbët nuk më mbajnë". Distopia e mësipërme është shembull i një tendosje maksimale të hapsirës imagjinuese të poetit. Bukuria e këtij imazhi poetik, sythos në momentin pranverizues që na ngjallë poezia. Dashje-pa-dashje, kur e thithim poezinë tërësisht, vargjet e mësipërme na ngrenë pranë një bote krejt tjetër, pranë një bote me një vizion më të pasur piktoresk, por gjithsesi, pranë një bote ku melankolia shpirtërore mohon vetveten sa për të harruar momentin... Vetëm poetët e kanë këtë instinkt magjik në shërbim të tyre. Këtu Dibrani arrinë t'na krijojë në imagjinatë momente ku na ngjanë se jemi pranë një prespektive ajërore, e cila na tërheqë pas vetes me mocionet dehëse të saj.

Mozaiku i ngjyrave të dramacitetit të brendshëm të Dibranit e ka epiqendrën tek një larmi trajtash, të brendshme dhe të jashtme, të aktualitetit jetësor të shqiptarëve të Kosovës. Pikënisjet e arkitekturës së rikonstruksionit poetik të Dibranit në këtë libër, janë pikërisht motivet e luftës për liri e pavarësi të këtij populli. Në poezitë "Unë dhe lumi", "Vizatimet e barbarëve", "Fushat dhe arat mbetën shkret", si the pothuajse në të gjithë ciklin "Portretet e përgjakura" Dibrani të krijon përshypjen e një termometri në gojën e njerzëve të tij. Ndonëse i pamundur të ndryshoi situatën e krijuar, merkuri shpirtëror i poetit ngrihet në nivel të njëjtë zjarmie poetike me atë të dramës emocionale dhe të peisazheve të brendshme të shqiptarëve gjatë luftës. Për këtë tip poezie akoma nuk kemi një teori të mirëfilltë letrare. Gjithsesi, Dibrani me arkivin e tij të hapur poetik, fton indirekt për një negociacion të nevojshëm midis kritikës letrare dhe formës së re krijuese të tij. Ky hap do t'u hapte rrugën prespektivave të reja në të ardhmen, kur është fjala për një risim të esencës mishëruese popul-poet. Kur poeti është, në kuptimin organik, pjesë e njeriut për të cilin ai krijon, kemi të bëjmë me një purifikim të realitetit gjatë transformimit e tij nga gjendja statike në atë të evoluimit poetik. Dhe ky purifikim është i nevojshëm.

Gjekë Marinaj/USA

FJALOR EMRASH SHQIP

Fjalori me emra shqip, të bazuar në emrat e perdorur nga iliret, arberit dhe shqiptarët brez pas brezi, i përgatitur nga gjuhëtarët A. Kostallari, M. Domi, P. Daka, S. Mansaku, "Fjalor me emra njerëzish", Sh. B. 8 Nëntori, Tiranë, 1982. Ja lista e emrave ku ju mund të zgjidhni një emër shqip apo ilir për femijen tuaj të porsalindur. Jemi shqiptarë dhe do të mbetemi të tille perjete! Perse mos të jeni dhe emrat tane, gjithashtu shqiptar apo ilir. Zgjedhja është e juaja!

EMRA PËR DJEM

Laidin
Laidon
Lalosh
Lalzak
Landër
Lartan
Lartim
Lartor
Larush
Lason
Lastar
Lavdërim
Lavdim
Lavdimir
Lavdor
Lazrim
Lazror
Led
Ledan
Ledar
Ledër
Ledian
Ledion
Ledor
Lek
Lekan
Lelërim
Lend
Lendar
Lesin
Letan
Levik
Ligjëror
Likan
Linaz
Lind
Lindamir
Lindiell
Linor
Lir
Lir
Lirak
Lirian
Liridash

EMRA PËR VAJZA

Laidona
Lajmime
Lajmora
Lajthiza
Lajza
Lanasa
Landare
Landra
Landroja
Lartana
Lartime
Lartore
Larushe
Lasonia
Lastare
Lauresha
Lavdërimë
Lavdi
Lavdie
Lavdime
Lavdimira
Lavduri
Lavdusha
Lazdrena
Lazrime
Lazrore
Leda
Ledana
Lediana
Lediona
Ledona
Ledra
Lekana
Leminota
Lenda
Lëndina
Lesina
Letana
Levika
Lidra
Ligjëresha
Ligjërimë
Ligjërore
Likana

Vijon

NJOFTIM

Faza e parë e konkursit „Kërkojmë talentet shqiptarë në diasporë“ është mbyllur. Në redaksinë tonë kanë ardhur rreth 70 fletëparaqitje. Gjatë shqyrtimit të tyre kemi konstatuar se disa prej tyre nuk kanë plotësuar kushtet sipas konkursit. Disa të tjerë që janë marrë në konsiderim nuk kanë dërguar fotot e tyre siç e kemi kërkuar. Andaj lusim, të gjithë ata konkurrenca që nuk kanë dërguar foto, adresën complete apo numrin e telefonit të kontaktit me udhëheqësin e konkursit në tel. 0170/381 59 87. Poashtu është mirë të lajmërohen të gjithë konkurrenca për caktimin e termineve për pjesëmarrje. Konkursi do të fillojë më 22 nëntor 2003 në diskotekën "Paradise" afër Frankfurt dhe do të zgjasë disa javë. /Diskoteka "Paradise" Frankfurt

